



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.04.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **Roza Komani B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë ", **Nr. i prokurimit- 632-23-1544-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-012-521**, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Roza Komani B.I.**, e dt.18.04.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë ", **Nr. i prokurimit- 632-23-1544-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-012-521**, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 12.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **12.04.2023**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.18.04.2023, Operatori Ekonomik **Roza Komani B.I.**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë ", **Nr. i prokurimit- 632-23-1544-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-012-521**.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë është i pabazuar, sepse nuk mendojmë se nënshkrimi i inxhinjerit Avni Azemaj është i bartur nga CV-ja.

Për sqarimin tuaj Avni Azemaj është Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik, kurse Inxhinjer i elektros është Ardian Ibraj.

Pretendimi juaj i dytë lidhur me logon e Komunës së Prishtinës në kontratën për “Rregullimi i kulmit në shkollën “Nexhmi Mustafa”, që ka paraqitur lideri i grupit, është i pabazuar, sepse AK ka verifikuar kontratën në fjalë të ngarkuar në platformën e e-prokurimit nga Komuna e Prishtinës dhe ka qenë e njëjta llojo.

Këtë gjë mund ta verifikoni edhe vet në platformë (shih kontratën nr.616-20-2749-5-2-5, të ngarkuar në platformë nga Komuna e Prishtinës).

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës